REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA K
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE
Nr. 325/20
Datë/Datum. 26.06.2020
PRISHTINË - PRISTINA

PSH.nr.325/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "K.S Besa Security Sh.p.k"-Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve institucionale të Komunës së Skenderajt - Ritender", me nr. të prok: 643-20-961-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Skenderaj, më datën: 25.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "K.S Besa Security Sh.p.k"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve institucionale të Komunës së Skenderajt - Ritender", me nr. të prok: 643-20-961-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Skenderaj.

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues / Komuna Skenderaj, ti bëjë ndryshimet e nevojshme në dosje e tenderit, në pajtim me nenin 53 të LPP-së, dhe të zgjasë afatin për ofertë, lidhur me aktivitetin të prokurimit: "Sigurimi fizik i objekteve institucionale të Komunës së Skenderajt -Ritender".

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "K.S Besa Security Sh.p.k"-Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI . Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "K.S Besa Security Sh.p.k"-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 26.05.2020 me nr.325/20, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve institucionale të Komunës së Skenderajt - Ritender", me nr. të prok: 643-20-961-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Skenderaj, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 9 dhe nenin 27 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 18.6 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 01.06.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 06.06.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues – Komuna Skenderaj, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është shërbim (kornizë 36 muaj), me vlerë të madhe. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për kontrate, përkatësisht kontestohet pozicioni nr. 3, i kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional. - Parashtruesi i ankesës përveç kërkesës për sqarim, ne afatin e paraparë me LPP i është drejtuar AK-së me kërkese për ri shqyrtim ku ka kërkuar që të përjashtohet kërkesa për Certifikatat (Smeta Sedec dhe BSCI). Megjithatë AK, ka refuzuar kërkesën me arsyetimin kryesor se kërkesa e tillë është mëse e nevojshme për shkak të trajtimit jo të mirë të punonjësve të sigurimit në të kaluarën.

Përgjigje në Pretendimin ankimor-1:

(Neni 113) Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se AK me aplikimin e kërkesës për Certifikata si të tilla detyrimisht qon në kufizim të konkurrencës apo edhe favorizim të ndonjë operatori ekonomik të caktuar dhe si e tillë bie ndesh me dispozitat e nenit 7, të LPP-së. - AK përmes vendimit kundrejt kërkesës për ri shqyrtim nuk ka dhënë ndonjë bazë ligjore për aplikim të kërkesës së kontestuar nga parashtruesi i ankesës, por ka potencuar që e njëjta është aplikuar pasi që në të kaluarën nuk janë trajtuar si duhet punëtoret e sigurimit fizik.

Lidhur me të drejtat dhe mbrojtjen e punëtoreve në Republikën e Kosovës ekzistojnë ligje dhe institucione të

veçanta, kompetente për ketë qeshje, rrjedhimisht AK duhet të aplikoj kërkesa të cilat janë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale me natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit (shih nenin 51 të LPP-së).

Si përfundim propozimi ynë për AK-në është që të largoj certifikatat e kontestuara nga parashtruesi i ankesës në mënyre që të zgjeroj konkurrencën dhe nëse e shef të nevojshme mund të vendos kërkesa të veçanta për ekzekutim të kontratës në kuptim të nenit 18 të RRUOPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar dhe të obligohet AK që konform nenit 53 të LPP-së të zgjas afatin për ofertë dhe ti bëjë ndryshimet e mundshme në dosje të tenderit.

Autoriteti Kontraktues, me datë 05.06.2020, me anë të shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues, mirëpo te njëjtit nuk kanë kthyer përgjigje.

Operatori Ekonomik me datë: 05.06.2020 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "K.S Besa Security Sh.p.k"-Prishtinë se pozicioni nr. 3, i kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional është kërkesë diskriminuese duke kërkuar që të përjashtohet kërkesa për Certifikatat (Smeta Sedec dhe BSCI). Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK me aplikimin e kërkesës për certifikata të tilla detyrimisht qon në kufizim të konkurrencës apo edhe favorizim të ndonjë operatori ekonomik të caktuar dhe si e tillë bie ndesh me dispozitat e nenit 7 të LPP-së. Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK përmes vendimit kundrejt kërkesës për ri shqyrtim nuk ka dhënë ndonjë bazë ligjore për aplikim të kërkesës së kontestuar nga parashtruesi i ankesës, por ka potencuar që e njëjta është aplikuar pasi që në të kaluarën nuk janë trajtuar si duhet punëtoret e sigurimit fizik. Lidhur me të drejtat dhe mbrojtjen e punëtoreve në Republikën e Kosovës ekzistojnë ligje dhe institucione të veçanta, kompetente për ketë qeshje. Rrjedhimisht, AK duhet të aplikoj kërkesa të cilat janë drejtpërdrejtë

relevante dhe proporcionale me natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit (shih nenin 51 të LPP-së).

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues vjen në përfundim se AK duhet që të largoj certifikatat e kontestuara nga parashtruesi i ankesës në mënyre që të zgjeroj konkurrencën dhe nëse e shef të nevojshme mund të vendos kërkesa të veçanta për ekzekutim të kontratës në kuptim të nenit 18 të RRUOPP-së. Andaj, obligohet AK që konform nenit 53 të LPP-së të zgjas afatin për ofertë dhe ti bëjë ndryshimet e nevojshme në dosje të tenderit dhe njëherit duke vepruar në pajtim me sqarimet e dhëna nga eksperti shqyrtues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Skenderaj

1x1 OE -"K.S Besa Security Sh.p.k"-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.